



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 29 Prill 2021

Nr: 47

VENDIM I NDËRMJETËM  
PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 25, DATË  
28.04.2021 DHE NR. 26, DATË 29.04.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 25, datë 28.04.2021 dhe nr. 26, datë 29.04.2021 të paraqitura në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe neni 65, shkronja “ç” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

### V Ë R E N:

Anëtarët e KZAZ-së nr. 35, qarku Tiranë, kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 25 regj, datë 28.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 316, datë 26.04.2021 të KSHZ-së “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari KZAZ-së nr. 35, qarku Tiranë”.

Po ashtu anëtarët e KZAZ-së nr. 22, qarku Durrës kanë paraqitur pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 26 regj, datë 29.04.2021. Objekti i kësaj kërkesë ankimore është kundërshtimi i vendimit nr. 309, datë 26.04.2021 të KSHZ-së “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 22, qarku Durrës”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 29.04.2021, vendosi të kalonte për shqyrtim dy kërkesat ankimore të paraqitura në KQZ në datën 28.04.2021 dhe 29.04.2021. Relatorët e kërkesave ankimore, përkatësisht z. Elvin Lako dhe z. Ledio Braho konstatuan se të dy kërkesat ankimore kundërshtojnë sanksionet administrative të vendosura nga Komisioneri në bazë të nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Të dy kërkesat janë iniciuar nga KZAZ që ankimojnë vendimmarrje të KSHZ-së që lidhen me afatin e parashikuar në pikën 1 të nenit 122 të K.Zgjedhor.

Neni 65 shkronja “ç” i K.Pr.Administrative parashikon se “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme: ... ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore*”.

Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 25, datë 28.04.2021 është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 26, datë 29.04.2021, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Elvin Lako.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe neni 65, shkronja “ç” i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

## **V E N D O S I:**

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 25, datë 28.04.2021, të paraqitur nga anëtarët e KZAZ-së nr. 35, qarku Tiranë dhe nr. 26, datë 29.04.2021, të paraqitur nga anëtarët e KZAZ-së nr. 22, qarku Durrës.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 04.05.2021, ora 13:00, nga relatori z. Elvin Lako.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

**Elvin LAKO - Relator**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**

